

1. Presidenti i Republikës mirëpriti ftesën për të mbështetur veprim - tarinë “Ditët e Trashëgimisë Kulturore dhe Artizanatit” në Gjirokastrë

Presidenti Bamir Topi iu përgjigj pozitivisht kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë për të qenë president nderi i këtij aktiviteti. Në letrën e tij Presidenti shprehu “gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme”. Ndërkohë komiteti organizues, i përbërë nga përfaqësues të Bashkisë Gjirokastrë, GCDO-së dhe shoqatës “Miqësia” vazhdon përpjekjet për gjetjen e fondeve dhe organizimin e kësaj ngjarjeje, e cila do zhvillohet në Gjirokastrën historike më 27-29 shtator 2008.

2. Përvjetori i parë i Qendrës së Artizanatit - 18 Maj 2008

Qendra e Artizanatit, e krijuar vitin e kaluar nga GCDO në bashkëpunim me Konfederatën e Artizanatit Shqiptar, mbushi një vit veprimtari të dendur dhe të suksesshme. Numri i artizanëve që shesin këtu produktet e tyre është rritur nga 25 në 45, me një gamë më të gjerë produktesh prej guri, druri, pambuku, leshi, bakri, hekuri e argjendi. 25 prej tyre janë artizanë nga Gjirokastra. 1259 vizitorë të huaj kanë vizituar qendrën dhe 1/3 prej tyre kanë blerë produkte. Qëllimi i saj është promovimi i traditës artizanale gjirokastrite dhe mbështetja e artizanëve lokalë.

3. GCDO promovon Gjirokastrën në panairët e turizmit

GCDO vazhdon promovimin e vlerave të Gjirokastrës turistike. Një pavion i vogël me material publiciteti u krijua në ditën e hapjes së sezonit turistik në Sarandë, si dhe në Tepelenë ku u festua 10 vjetori i kompanisë për prodhimin e ujit “Tepelena”. Me ftesë të Shoqatës së Investitorëve të Huaj të Shqipërisë dhe Elida-Co, GCDO mori pjesë në panairin në Tiranë me temë “Shqipëria – një



destinacion i mirë për investime” i shoqëruar dhe me një konferencë me të njëjtën temë (27-30 maj). Mendimi i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte se Gjirokastra ka potencial të madh turistik, por duhen shumë investime për të mbrojtur trashëgiminë e saj.

4. Katër vullnetarë të Korpusit të Paqes nisin punë në Gjirokastër

Në mes të qershorit, 4 vullnetarë të rinj erdhën nga organizata amerikane e Korpusit të Paqes për të jetuar dhe punuar në Gjirokastër. Për dy vjet ata do të punojnë në sektorët e shëndetësisë, mësimit të gjuhës dhe konservimit.

Tara Durham, vullnetare për zhvillimin e komunitetit, e atashuar pranë GCDO-së dhe parkut të Antigonesë, shprehet “e kënaqur që po punon pranë GCDO-së, që është e mirëorganizuar dhe vepron me projekte të vlefshme për shpëtimin e këtij xhevahiri historik”.



5. Vizitë nga anëtarë të bordit drejtues të *American School of Classical Studies* në Athinë dhe *Gennadius Library*



Vizita në Shqipëri e anëtarëve të bordit të *American School of Classical Studies* në Athinë dhe *Gennadius Library* përfshinte edhe një qëndrim në Gjirokastër. Të ftuar nga Fondacioni “Butrinti” dhe Qendra Ndërkombëtare për Arkeologjinë Shqiptare, 19 anëtarë të bordit vizituan pazarin, Muzeun e Armëve dhe shtëpinë e Zekateve. Kryetari Bashkisë Flamur Bime u uroi

miqve mirëseardhjen, ndërsa GCDO ishte mikpritësja e tyre. Qëllimi i vizitës ishte njohja me sfidat që përfaqëson shpëtimi i trashëgimisë kulturore ndërtimore në Gjirokastrë.

6. Pastrimi i Kalasë së Gjirokastrës



Para pastrimit

Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, GCDO ndërmorri pastrimin e mbeturinave shumëvjeçare të grumbulluara për vite me radhë në mjedise të ndryshme të Kalasë së Gjirokastrës, përfshirë edhe hapësirën pranë tyrbes bektashiane.



Pas pastrimit

Ky aksion do të pasohet nga pastrimi i vegetacionit të dëmshëm dhe vendosja e koshave për mbeturinat. Në vazhdim është domosdoshmëri ndërgjegjësimi publik për ruajtjen pastër të këtyre mjedisve.

7. Gjirokastra.org

Së fundmi u bë aktive faqja dygjuhëshe e internetit (shqip dhe anglisht) që synon të promovojë qytetin e gurtë në botën e jashtme. Aty pasqyrohet historia e qytetit, vendet me interes për t'u vizituar dhe informacion praktik për të qëndruar në qytet. Faqja e internetit është fryt i një pune njëvjeçare të vullnetarëve të Korpusit të Paqes, akademikëve dhe stafit të GCDO-së. Një pjesë e tij i kushtohet pikërisht punës së GCDO-së në Gjirokastrë. Më shumë informacion mund të gjeni në adresën www.gjirokastra.org.

8. Një strehim i nëndheshëm i kohës së komunizmit, së shpejti tërheqje turistike

Një sistem i tërë strehimi nëntokësor i ndërtuar gjatë viteve të komunizmit, mund të bëhet së shpejti një tërheqje tjetër turistike në Gjirokastrë. Bashkia e Gjirokastrës kërkoi ndihmën e GCDO-së për ta bërë të vizitueshëm këtë mjedis me dhjetëra metra korridore dhe mbi 50 dhoma. Lajmi tërhoqi vëmendjen lokale dhe kombëtare. Qëllimi është që në të ardhmen të krijohet një muze lokal i Luftës së Ftohtë. Kjo do të thotë të pasqyrosh edhe trashëgiminë moderne të Shqipërisë në një qytet historik si Gjirokastra!



9. Universiteti i Pensilvanisë në Gjirokastrë

Një grup me 4 profesorë dhe studentë të departamentit të Arkitekturës së Peisazhit në Universitetin e Pensilvanisë punuan në Gjirokastrë për të përgatitur propozimin për një master plan të peisazhit urban. Puna e tyre u përqëndrua në përdorimin dhe përmirësimin e një rrjeti rrugësh për këmbësorë që do të lehtësojnë lëvizjen në këmbë nëpër pika të ndryshme të qytetit qoftë për vendasit, ashtu edhe për vizitorët. Po ashtu, ato hartuan një skemë paraprake për përmirësimin e shfrytëzimit të hapësirave të lira publike në Kala dhe në sheshin Çerçis Topulli, si dhe për të gjetur një shteg këmbësor për lidhjen e tyre drejtpërdrejt.

Ekipi studioi mundësinë e një shtegu turistik nga fshati Asim Zeneli për në Antigone, që do të bëjë të mundur vizitën në Park të këmbësorëve përmes natyrës së bukur të kodrave përreth. Ky ekip së shpejti, do të ofrojë sugjerime për përmirësimin dhe zhvillimin e kësaj mundësie.

10. Rritja e numrit të turistëve

Deri tani, sipas Zyrës së Informimit Turistik, që administrohet nga GCDO, Gjirokastra është vizituar këtë vit nga rreth 4431 turistë, shumica në muajt prill, maj, qershor dhe korrik. Kjo shifër shënon një rritje prej 37 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit

të kaluar. Sipas një studimi të bërë nga PNUD dhe GCDO turistët gjejnë kënaqësi në vizitat e tyre dhe do u rekomandojnë miqve të vet që të vijnë në Gjirokastrë. Ata mendojnë se qyteti ka njerëz mikpritës, një peizazh të mrekullueshëm dhe trashëgimi arkitekturore interesante, por pak prej tyre mendojnë të kthehen përsëri. Studimi gjithashtu tregoi se po të kishte më shumë mundësira, turistët do të shpenzonin më shumë para!

Aktiviteti	Përqindja
Vizitë në muze	70.0%
Fotografi	57.0%
Tur në qytet	46.5%
Ekskursionet/ecje	39.0%
Të tjera	14.5%
Muzikë lokale/ngjarje kulturore	7.5%
Piknikë	5.5%
Biçikletë/motoçikletë	2.0%
Shëtitje me kalë	0.5%

11. Rinia e Gjirokastrës në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve

Më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, GCDO dhe shoqata “Miq të Monumenteve” e nxënësve të shkollës së mesme të përgjithshme “Asim Zeneli” u mbledhën dhe diskutuan mbi projektin për ngritjen në Kala të një muzeu për Gjirokastrën, përkohësisht të quajtur “Kronikë në gur”. Pasi projekt - ideja u nda me të rinjtë, u diskutua se si muzeu mund të ndihmojë brezat e rinj për të afruar rininë gjirokastrite me trashëgiminë kulturore të qytetit.



Sipas një anketimi të bërë nga GCDO, duhet bërë shumë më shumë për të afruar të rinjtë me qytetin.

- 48% e të rinjve janë krenarë për qytetin dhe trashëgiminë e tij, vetëm 16 % e tyre e shohin të ardhmen e vet në Gjirokastrë, ndërsa 47% u përgjigjën “ndoshta”.

- Vetëm 39% e të intervistuarve iu përgjigjën pozitivisht pyetjes “A të pëlqen të jetosh në Gjirokastrë?” Ndërsa 38 % nuk janë të sigurt për këtë.
- 79% e rinisë gjirokastrite është e vetëdijshme për potencialin turistik të qytetit dhe mendojnë se atraksioni me i madh turistik janë shtëpitë karakteristike (80%). Shumica e të rinjve janë skeptike për të ardhmen e tyre në Gjirokastrë, ndërsa mjaft të rinj po mendojnë për të zgjedhur profesione të tilla si guida turistike, arkitektë dhe inxhinierë.

Faleminderit !

**Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në spetrela@gjirokastra.org ose në cel 06920 78767.*